

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje mjete didaktike”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
37000000-8, 37413220-4, 37520000-9, 37523000-0.

VLERA E FONDIT LIMIT:

**- Fondi total 4 868 800 (katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë
pa T.V.SH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm në përmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2022, 2023 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
 - Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatë ISO 9001:2015 lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë të produkteve, ose ekuivalente, të vlefshme, për prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa për çertifikatën ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë të produkteve, ose ekuivalente, të vlefshme, për prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve objekt prokurimi, është vendosur nga A, pasi kërkon të sigurohet që OE konkurues plotëson kërkesat dhe standardet për instalimin e një sistemi sigurie të produkteve që ai tregëton.

2.3.3 OE, për cdo mjet didaktik/lodër duhet të paraqesë “Deklaratë CE të Konformiteti”, në përputhje me standardet e CE.

Deklarata e konformitetit identifikon artikullin për të cilën kjo deklaratë është hartuar.

Në deklaratën e konformitetit të paraqitur duhet të duket qartazi lidhja e produktit të paraqitur, me deklaratën e konformitetit.

Argumentimi: Kërkesa që OE, për cdo lodër duhet të paraqesë “Deklaratë CE të Konformiteti”, në përputhje me standardet e CE, është vendosur për të vërtetuar që produktet objekt prokurimi plotësojnë kërkesat cilësore në raport me standardet CE të konformitetit për këto produkte duke marrë në konsideratë moshën e fëmijëve që do të përdorin këto artikuj, si dhe legjislacionin përkatës të sipërpërmendur.

Kërkesa për certifikimin CE i është referuar:

- Ligjin Nr. 10489 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", datë 15/12/2011; Ky Ligj është mbështetur plotësisht me vendimin nr. 768/2008/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 "Mbi kuadrin e përbashkët për tregtimin e produkteve.
- Ligjin Nr. 10480, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", datë 17/11/2011;
- VKM nr. 262, datë 03.04.2013 "Për miratimin e rregullit teknik për Sigurinë e Lodrave". Ky VKM është mbështetur në Direktivën 2009/48/EC të Parlamentit Evropian, të datës 1 mars 2012 "Për sigurinë e lodrave" EUR-Lex, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 170 e datës 30.6.2009.

2.3.4 OE duhet të paraqesë katalog ose pjesë të katalogut ku të tregohen qartazi lloji i artikullit (lodrës) përmasat dhe të dhënat e prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa që OE duhet të paraqesë katalog ose pjesë të katalogut pasi ne katalog pershkruhen lloji i lodres, markimi CE, të dhënat e prodhuesit, permasat dhe pershkrimi i produktit. Kjo kerkese është vendosur me qëllim që AK të realizojë kontrollin dhe lidhjen midis specifikimeve teknike të kërkuar për secilën prej produkteve, përmasat e tyre, formën dhe të dhënat e prodhuesit.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon 1 (një) automjet qe do te sherbeje per transportin e produkteve objekt prokurimi me masë maksimale të autorizuar 1-1.5 ton, ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 1 (një) automjet, ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik

Në rastin kur automjeti është me qera/në përdorim, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

Argumentimi: Kërkesa që OE të disponojë një automjet me masë maksimale të autorizuar 1-1.5 ton, është vendosur pasi lëvrimit i mallit pranë magazinës të AK do të kryehet menjëherë për gjithë sasinë e artikujve, përsa më sipër AK nëpërmjet këtij kriteri do të sigurohet që OE ka kapacitet për të përmbushur nevojat e AK brenda afatit të përcaktuar në grafikun e lëvrimit.

2.3.6 Ditën e hapjes së tenderit, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një mostër të realizuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor dhe sipas deklaratës së konformitetit të depozituar në SPE sipas kriterit 2.3.3.

Mostrat do te paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave prane D.P.Ç.K., Rruga e Barrikadave, Çerdhje nr. 1, Tirane.

Në secilën lodër duhet të jetë qartazi i dukshëm markimi “CE”.

Markimi CE vendoset në lodër në një etikete të fiksuar në lodër ose në paketimin e saj në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqeshme.

Cdo artikull duhet të jetë i ambalazhuar në ambalazh te personalizuar, në të cilët duhet të duken qartazi emri dhe adresa e prodhuesit.

Në amblazhin e secilit artikull duhet të jetë etikimi në gjuhën shqipe për:

- Emërtimin e mjetit didaktik/ lodrës
- Përshkrim i shkurtër i mënyrës së përdorimit.
- Materiali përbërës i artikullit (lodrës).

Mosha e këshilluar për përdorim.

Vendi i origjinës

Etiketat e vendosura dhe instruksionet e përdorimit që shoqërojnë artikujt duhet të tërheqin vëmendjen e përdorueseve ose mbikëqyrësve të tyre mbi rreziqet dhe risqet e mundshme të dëmtimit që përfshihen gjatë përdorimit të lodrave si dhe mënyrat mbi shmangiet e rreziqeve dhe risqeve të tilla.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila të përmbajë të dhënat: Mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik. Etiketa e ngjitur nuk duhet të mbulojë të dhënat e kërkuara më sipër.

Mos paraqitja mostrave të kërkuara në vendin, ditën dhe orën e hapjes së ofertave për të gjithë mallrat objekt prokurimi është kusht për skualifikim.

Argumentim: Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 6/a. Kërkesa që OE të paraqesë mostra ditën e hapjes së tenderit është vendosur për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqëruar të paraqitur në SPE, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit e kontrates.

II. Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

Hartimi i specifikimeve teknike për mjetet didaktike është bërë duke iu referuar shkresës së Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kujdesit në D.P.Ç.K, dhe Sektorit të Zhvillimit dhe Kujdesit Psiko-Social për llojet dhe format e mjeteve didaktike për kopshtet dhe çerdhet e Tiranës, grupmoshave për të cilat do të përdoren këto mjete didaktike.

- Ligjin Nr. 10489 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", datë 15/12/2011;
 - Ligjin Nr. 10480, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore", datë 17/11/2011;
 - VKM nr. 262, datë 03.04.2013 “Për miratimin e rregullit teknik për Sigurinë e Lodrave”.
- Për përcaktimin e specifikimeve janë patur parasysh plotësimin e Kërkesave Thelbësore të Sigurisë:

Kërkesat e përgjithshme të sigurisë

Lodrat nuk duhet të rrezikojnë sigurinë ose shëndetin e përdoruesve ose palëve të treta kur ato përdoren si janë përcaktuar ose në mënyrën e parashikuar, duke pasur parasysh edhe sjelljen e fëmijëve (sidomos në rastin e grupmoshës nën 6-muaj deri në 6 vjeç)

Kërkesat e veçanta të sigurisë

1. Karakteristikat Fizike dhe Mekanike (të jenë të qëndrueshme, mos të kenë pjesë të vogla,)
2. Ndezshmëria (të mos ndizen nëse ekspozohen ndaj flakës, të japin një përhapje të ulet të flakës)

3. Vetitë Kimike nivelet e substancave mutagjene kancerogjene (CMR), e 19 metaleve të rënda si Cadmiumi, 55 substancat alergjene)
4. Karakteristikat Elektrike (Jo tension nominal >24 volt , temp të mos shkaktoj djegie, bateritë e fshehura të paksesushme nga fëmijët)
5. Higjiena (të shmangët risku ndaj infektimit, të mundësohet larja)
6. Radioaktiviteti (sipas legjislacionit per radioaktivitetin)

Lidhjet e lodrave duhet te kenë fortësinë e duhur mekanike, qëndrueshmërine për te përballuar pa risk sforcimet;

Pjesët e mprehta, te ngriturat, kontakti me to te jenë të reduktuara sa më shume.

Nuk duhet të paraqesin risk lidhur me mbytjen, gëlltitjen nga pjesët e vogla

Paketimi i lodrave (përmasat e përshtatshme të pacoptueshme për nën 36 muaj)

Lodrat, qe japin lëvizshmëri, Sistemi i frenimit duhet te jete lehtësisht i përdorshëm

Temperatura maksimale dhe minimale në çdo sipërfaqe të mos shkaktojë dëmtime kur preket (lodrat me bateri, elektrike);

Kufiri i vlerave maksimale te impulsit të zhurmës dhe vazhdueshmërisë se zhurmës se tingullit (lodrat me tinguj, muzikore)

Të reduktojnë mundësisht sa më shume riskun e shtypjes ose te kapjes të pjesëve te trupit, të rrobave dhe veshjeve, përplasjeve dhe mbytjes. (lodrat aktivizuese) etj

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.